



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

RAPORTI GJYSËMVJETOR I VITIT 2024, PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

1. Përmbledhja ekzekutive (*pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë*)

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) ka miratuar vendimin nr.326 datë 29.05.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024-2030”, për të cilin procesi i konsultimit publik është realizuar përgjatë muajit tetor – nëntor 2023.

Procesi i konsultimit është kryer nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe aktiviteteve të tjera konsultative.

Vendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut, 2030” është konsultuar në tryeza të përbashkëta, me Shoqatat e Mbrojtjes së Konsumatorit, me studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Shoqatat e Biznesit dhe Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë. Takim me donatorët dhe përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, në datën 27.07.2023, në mjediset e ish-Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Konsultimi në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” është realizuar në periudhën 12.10.2023 – 09.11.2023. Përmes publikimit në RENJK, në zbatim të ligjit 146/2014, janë ftuar qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik, të draft Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut, 2030. Projektvendimi, relacioni shpjegues, dokumenti strategjik dhe plani i veprimt, janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente. Nuk janë përcjellë komente nga konsultimi i projektvendimit.

Nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik mbetet një nga sfidat kryesore të gjithë administratës publike në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik, si një hallkë thelbësore në zinxhirin e procesit të hartimit të legjislacionit.

VKM nr. 326 datë 29.05.2024, është konsultuar gjatë vitit të kaluar por është miratuar në periudhën raportuese. Ky vendim ka qenë i planifikuar për konsultim në Planin e konsultimit publik për periudhën kur është konsultuar dhe nuk ka qenë i planifikuar në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projekt-akteve (PPAP) për vitin 2024.

MEKI ka realizuar procesin e konsultimit publik në masën 100%, duke konsultuar gjerësisht projektvendimin e miratuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

VKM nr. 326 datë 29.05.2024, i është nënshtruar një procesi kompleks dhe të zgjeruar konsultimi publik me grupet e interesit të fushës në takime të drejtpërdrejta dhe një masë të gjerë qytetarësh nëpërmjet platformës online të njoftimit dhe konsultimit publik.

Procesi krahasuar me vitin e mëparshëm është përmirësuar, lidhur me diversifikimin e mjeteve të përdorura për konsultim, rritjen e aksesit të qytetarëve në konsultim dhe në shkallën e reagimeve të mbledhura.

Përforcimi i kulturës pjesëmarrëse dhe nxitja e publikut për të rritur përfshirjen në proceset e politikbërjes mbetet një nga sfidat kryesore në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara për MEKI në 6 mujorin e parë të vitit 2024, deri në momentin e raportimit është 29 (njëzet e nëntë), 27 vendime të Këshillit të Ministrave të miratuara me propozim të MEKI dhe dy ligje për ratifikim marrëveshje ndërkombëtare.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Për sa i përket akteve të miratuara, Vendimet e Këshillit të Ministrave të miratuara me propozim të MEKI, nuk bëjnë pjesë tek aktet që kanë detyrimin për t’ju nënshtruar procesit të konsultimit publik. Me propozimin e MEKI-t është miratuar vendimi nr.326 datë 29.05.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024-2030” i cili është konsultuar gjatë vitit të kaluar.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Aktet e miratuara gjatë kësaj periudhe nuk janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45/1, shkronja a) në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për aktet e planifikuara dhe të miratuara në gjashtë mujorin e parë me propozim të MEKI-t, të planifikuara në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, PKIE, dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike.

Në PPAP 2024 për këtë gjashtë mujor janë planifikuar për konsultim dy projektligje për të cilat ka përfunduar periudha konsultimit, por janë ende në fazë bashkërendimi dhe nuk janë miratuar, të cilat janë pjesë e PKIE gjithashtu. Gjithashtu janë konsultuar dy dokumente strategjike si; Plani Menaxhimit Te Parkut Arkeologjik Bylis (Qytetet Antike të Bylisit dhe Klosit -2024-2029) dhe **Plani i Menaxhimit për ish- Burgun e Spaçit, të cilat priten të miratohen me VKM.**

Aktet e tjera të propozuara nuk i përkasin kategorisë së projektakteve që kanë detyrimin të konsultohen. Janë përgjashtuar 28 akte, vendime të Këshillit të Ministrave, dhe ligje për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat nuk janë objekt i ligjit.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Një projekvendim i miratuar për periudhën i paraqitur për konsultim publik në RENJK në periudhën 12.10.2023 – 09.11.2023.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Për shkak të ndryshimit të fushës së përgjegjësisë dhe krijimit të një portofoli të ri ministror që përfshin ekonominë, kulturën dhe inovacion, caktimit të prioritetëve, nuk është arritur të realizohet procesi i konsultimit publik dhe as të miratohet projektligji "*Për trajtimin financiar të punonjësve që kanë punuar në institucionet publike të artit dhe kulturës*" i parashikuar në Planin Vjetor të Konsultimit Publik për vitin 2024 për ish ministrinë e Kulturës.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Për konsultimin e vendimit nr.326 datë 29.05.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024-2030" janë zhvilluar konsultimet publike duke përdorur këto metoda:

- i. Publikimi i draftit të projektvendimit në Regjistrin Elektronik nga data 12.10.2023-09.11.2023.
- ii. Njoftimi dhe Konsultimi me anë të takimeve konsultative dhe zhvillimi i takimeve publike

Nga konsultimet publike të kryera më së shumti janë marrë komente/sugjerime të cilat kanë qenë të reflektuara në draft strategji. Nisur nga ky fakt, këto metoda konsultimi rezultojnë të jetë metoda më efikase.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Njoftimi dhe Konsultimi i vendimit nr.326 datë 29.05.2024, është realizuar edhe me anë të takimeve konsultative me grupet e ndryshme të interesit, e cila rezultoi metoda më efektive e konsultimit për projekt-aktin.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Hartimi i VKM nr.326 datë 29.05.2024, për shkak se ngarkon me zbatimin e saj një sërë institucioneve ka qenë objekt konsultimi paraprak me institucione si; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Entet rregullatore: Enti Rregullator i Energjisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Enti Rregullator i Ujit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Aviacionit Civil, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Institucionet e Infrastrukturës së cilësisë: Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Përgjithshme Metrologjisë. Institucionet mbikëqyrëse/inspektuese të tregut: Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut, 2030” është konsultuar në tryeza të përbashkëta, me Shoqatat e Mbrojtjes së Konsumatorit, me studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Shoqatat e Biznesit dhe Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, në datën 20 Dhjetor 2022, pranë mjedisëve të Xheko Imperial, si dhe takim me donatorët dhe përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, në datën 27.07.2023, në mjediset e ish-Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Projektvendimi ka qenë i publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) në periudhën 12.10.2023 – 09.11.2023. Ndërkohë që janë zhvilluar takime në kuadër të konsultimit në datën 20 Dhjetor 2022 me Shoqatat e Mbrojtjes së Konsumatorit, me studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Shoqatat e Biznesit dhe Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Procesi i konsultimit është kryer duke respektuar afatet të cilat fillojnë që nga momenti i njoftimit, kryerjes së takimeve dhe afatit të lënë për marrjen e komenteve. Konkretisht, për projektligji ka qenë i publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) në datat 12.10.2023 – 09.11.2023.

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për këtë periudhë ishte 12(dymbëdhjetë) muaj. Kjo përlllogaritje është bërë duke patur në vëmendje kohën (numrin e muajve) gjatë të cilës ka filluar

puna për identifikimin e grupeve të interesit, hartimin e draftit, publikimin e tij në RENJK, zhvillimin e takimeve konsultative, marrjen dhe vlerësimin e komenteve dhe përgatitjen e një drafti final për projektaktin.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata këtë vit është përmirësuar, krahasuar me të njëjtën periudhë me një vit më parë, sepse është miratuar një projektet i konsultuar gjerësisht krahasuar me të njëjtën periudhë. MEKI është angazhuar të ftojë sa më shumë aktorë të përfshirë për konsultim publik duke mirëpritur sugjerimet dhe zhvilluar bashkëbisedime me to. Po ashtu, koordinatori dhe strukturat e hartimit janë bërë pjesë e trajnimeve të zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në të kuptuarit më mirë të rëndësisë dhe në menaxhimin më të mirë të këtij procesi, si dhe në bashkëpunimin me efektiv me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në grupin e punës për hartimin e projektaktit nuk ka pasur aktor të jashtëm jo-qeveritarë, të përfshirë.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Nuk ka pasur anëtarë të jashtëm.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Në procesin e konsultimit publik ka patur rreth 70 aktorë nga publiku i gjerë. Shumica kanë përcjellë sugjerime dhe pyetje të cilat janë ezauruar në takime.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Në procesin e konsultimit publik kanë marrë pjesë Shoqatat e Mbrojtjes së Konsumatorit, Shoqata e Biznesit, Studentët e Fakultetit të Drejtësisë, dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Numri i pjesëmarrësve ka qenë më i lartë se vitet e kaluara po numri i sugjerimeve të përcjella ka qenë më i ulët.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në konsultimin e realizuar për projektaktin është marrë vetëm një sugjerim.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

I vetmi koment i dhënë është pranuar dhe reflektuar në projektakt.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin 2023 ka pasur numër më të ulët sugjerimesh pavarësisht se janë realizuar disa takime konsultative për të përfshirë një numër të gjerë të grupeve të interesit por edhe sepse strategjia ka rezultuar një dokument i mirë hartuar dhe gjithëpërfshirës.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Akti i konsultuar dhe miratuar gjatë kësaj periudhe nuk është objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45 të Rregullores së Këshillit të Ministrave.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

MEKI publikoi raportin e Konsultimit në sistemin RENjK për projektvendimin e miratuar.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsytet?

Është publikuar.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni

informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Si konkluzion konstatojmë se procesi i konsultimit të këtij akti ka rezultuar i suksesshëm, pasi konsultimi me një audiencë të gjerë ka ndihmuar në njohjen dhe përcjelljen te publiku të këtij dokumenti të rëndësishëm për konsumatorin. Vetëvlerësimi 8.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfida kryesore mbetet nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik. Për të bërë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut, nëpërmjet dhënies së mendimeve/sugjerimeve kërkohet angazhimi i të gjitha institucioneve shtetërore, të përfshira në procesin e konsultimit. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ.